

Statistikat e transportit*

Korrik 2020

Tiranë, më 27 Gusht 2020: Në muajin Korrik 2020, volumi i mallrave dhe numri i pasagjerëve të transportuar me rrugë detare, ajrore dhe hekurudhore, rezultojnë me ulje si pasojë e situatës së pandemisë së Covid-19.

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Korrik 2020 është 378 mijë tonë, duke u ulur 7,9 %, krahasuar me Korrik 2019.

Në shtatëmujorin e 2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 2.410 mijë tonë, duke u ulur me 8,7 %, krahasuar me shtatëmujorin e 2019.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në muajin Korrik 2020 është 2,2 milionë tonë-kilometër, duke u ulur me 38,6 %, krahasuar me Korrik 2019.

Në shtatëmujorin e 2020, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 14,3 milion tonë-kilometër, duke u ulur me 37,9 %, krahasuar me shtatëmujorin e 2019.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periodha	Me det /tonë	Hekurudhë 000/tonë.km	Ajër /tonë*
Korrik 2019	409.859	3.548	203.3
Korrik 2020	377.510	2.179	164.3
Ndryshimi vjetor (%)	-7,9	-38,6	-19,2
Janar-Korrik 2019	2.639.539	23.046	1.348.4
Janar-Korrik 2020	2.410.264	14.306	1.008.8
Ndryshimi vjetor (%)	-8,7	-37,9	-25,2

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në muajin Korrik 2020, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 164,3 tonë mallra, duke u ulur me 19,2 %, në krahasim me Korrik 2019.

Në shtatëmujorin e 2020, me ajër janë transportuar 1.009 tonë mallra duke u ulur 25,2 %, krahasuar me shtatëmujorin e 2019.

Numri i fluturimeve të kryera, në Korrik 2020 është 1.926 duke shënuar një rënie me 40,1 %, ndaj Korrik 2019.

Për publikim 27/08/2020

Vijon

* Ky publikim nuk përfshin volumin e mallrave dhe numrin e pasagjerëve të transportuar nëpërmjet transportit rrugor.

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Korrik 2019	20	3.216	24.234
Korrik 2020	21	1.926	10.151
Ndryshimi vjetor (%)	5,0	-40,1	-58,1
Janar- Korrik 2019	20	15.939	105.470
Janar- Korrik 2020	21	7.504	43.916
Ndryshimi vjetor (%)	5,0	-52,9	-58,4

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat në fillim të vitit janë licensuar të kryejnë fluturime

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Korrik 2020 është 53.414 pasagjerë. Krahasuar me Korrik 2019, ky tregues është ulur 77,1 %.

Në shtatëmujorin e 2020, kanë udhëtuar me linjë detare 205.751 pasagjerë, duke u ulur me 71,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në muajin Korrik 2020, transporti ajror i pasagjerëve zë 72,2 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në shtatëmujorin e 2020 është 706.556 pasagjerë duke u ulur me 60,7 %, krahasuar me shtatëmujorin e 2019.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Korrik 2019	10.429	232.975	385.388
Korrik 2020	4.948	53.414	151.677
Ndryshimi vjetor (%)	-52,6	-77,1	-60,6
Janar- Korrik 2019	40.037	715.797	1.796.867
Janar- Korrik 2020	5.012	205.751	706.556
Ndryshimi vjetor (%)	-87,5	-71,3	-60,7

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Korrik 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 81,0 mld lekë dhe 50,6 % e tyre u transportua me det.

Në shtatëmujorin e vitit 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 477,7 mld lekë dhe 50,6 % e tyre u transportua me det.

Tab. 4 Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Mënyra e transportit	Eksport (mln lekë)				Import (mln lekë)			
	Korrik 2019	Korrik 2020	Jan.-Korr. 2019	Jan.-Korr. 2020	Korrik 2019	Korrik 2020	Jan.-Korr. 2019	Jan.-Korr. 2020
Transport detar	16.420	13.977	106.497	84.554	29.759	27.011	185.587	157.283
Transport hekurudhor	-	2	4	2	492	195	2.530	1.758
Transport rrugor	10.869	10.428	70.490	62.867	26.138	27.081	161.165	151.746
Transport ajror	112	53	535	513	1.900	1.352	11.750	9.137
Të tjera	353	79	2.576	1.980	1.469	796	16.401	7.848


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Eksportet e mallrave

Në Korrik 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 57,0 %, me rrugë 42,5 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë ulur me 4,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në shtatëmujorin e 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 56,4 %, me rrugë 41,9 % dhe me ajër 0,3 %. Në shtatëmujorin e vitit 2020, mallrat e eksportuara me rrugë janë ulur 10,8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Korrik 2020



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Importet e mallrave


Në Korrik 2020, mallrat e importuara me det zënë 47,9 %, me rrugë 48,0 % dhe me ajër 2,4 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Korrik 2020 janë rritur me 3,6 % krahasuar me Korrik 2019.

Në shtatëmujorin e 2020, mallrat e importuara me det zënë 48,0 %, me rrugë 46,3 % dhe me ajër 2,8 %.

Në shtatëmujorin e 2020, mallrat e importuara me rrugë janë ulur me 5,8 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Korrik 2020



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve, sipas llojeve, si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit, në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë